



QËNDRIMET E TË RINJVE NDAJ NORMAVE GJINORE DHE SHOQËRORE, ZHVILLIMIT DHE SIGURISË NJERËZORE NË KOSOVË

Dhjetor 2022

**QËNDRIMET E TË
RINJVE NDAJ NORMAVE
GJINORE DHE SHOQËRORE,
ZHVILLIMIT DHE SIGURISË
NJERËZORE NË KOSOVË**

Përmbajtja

Përmbajtja	5
1. Lista e tabelave dhe figurave	6
1. Përmbledhje ekzekutive	9
2. Konteksti i përgjithshëm	13
3. Metodologjia e anketës	15
4. Gjetjet e anketës	17
Zhvillimi i të rinjve	18
Normat shoqërore	23
Siguria njerëzore	27
5. Diskutime në grupin e fokusit	33
6. Shënime përmbyllëse dhe rekomandime	35

Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1.	Shpërndarja e mostrës	16
Tabela 2.	Statistikat përmblledhëse	17
Figura 1.	Arritjet arsimore	18
Figura 2.	Cilësia e arsimit	19
Figura 3.	Pritshmëritë për dobinë e arsimit të arritur	19
Figura 4.	Statusi i punësimit	20
Figura 5.	Preferencat për punë	21
Figura 6.	Prirja për emigrim	22
Figura 7.	Ndikuesit kryesorë në vendimmarrje	22
Figura 8.	Stereotipet gjinore	23
Figura 9.	Edukimi dhe pavarësia e vajzave/femrave të reja	24
Figura 10.	Emocionet dhe sjellja e djemve/meshkujve të rinj	24
Figura 11.	Dallimet në rolet dhe pritshmëritë gjinore	26
Figura 12.	Shqetësimet e sigurisë	27
Figura 13.	Siguria në mjedise të ndryshme (0-100)	28
Figura 14.	Perceptimet e pasigurisë dhe abuzimit	29
Figura 15.	Dhuna kundër grave	30
Figura 16.	Dallimet gjinore në lidhje me faktorët në rastet e sulmit seksual	30
Figura 17.	Përdhunimi dhe sulmi seksual	31
Figura 18.	Përvojat abuzive dhe shtypëse	32

Mirënjohje: Raporti për qëndrimet e të rinjve ndaj normave gjinore dhe shoqërore, zhvillimit dhe sigurisë njerëzore në Kosovë, është prodhuar nga Instituti Riinvest për Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, me financim nga Dritarja e Financimit e UNDP-së (Luksemburgu, Republika e Koresë, Suedia).

Mohim i përgjegjësisë: Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të të anketuarve dhe autorëve dhe nuk i paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të UNDP-së në Kosovë apo të donatorëve.

1

Përmbledhje ekzekutive

Ky studim mbi qëndrimet e të rinjve ndaj gjinisë dhe normave shoqërore, zhvillimit dhe sigurisë njerëzore në Kosovë¹ synon të kontribuojë në të kuptuarit më të mirë të pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të rinjve për arsimin, zhvillimin, mundësitë, migrimin, normat shoqërore dhe sigurinë njerëzore. Studimi bazohet si në analizën sasiore ashtu edhe në atë cilësore, duke e sjellë së bashku një anketë të realizuar në mbarë Kosovën dhe shtatë diskutime të thelluara në grupe të fokusit me të rinjtë dhe organizatat e shoqërisë civile. Studimi bazohet në një mostër përfaqësuese të popullatës së re të Kosovës dhe është i pari i llojit dhe madhësisë së tij në Kosovë. Rezultatet duhet të kontekstualizohen sipas periudhës së punës në terren, korrik-gusht 2022, kur inflacioni dyshifror dhe kriza energjetike mund t'i kenë përkeqësuar pabarazitë ekonomike dhe shoqërore.

Ky raport fillon me disa nga gjetjet kryesore, të ndjekura nga një pasqyrë e kornizës ligjore dhe e politikave për rininë dhe barazinë gjinore, si dhe një përmbledhje e metodologjisë. Më pas i shtjellon dhe i eksploron gjetjet në lidhje me qëndrimet ndaj arsimit dhe zhvillimit profesional, ndikimin e normave shoqërore dhe sigurinë njerëzore. Përfundimet ofrojnë rekomandime të fokusuara tek të rinjtë për avancimin e barazisë gjinore në përgjigje ndaj disa prej sfidave dhe mundësive kyçe të identifikuara.

Gjetjet kyçe

Përafërsisht një e treta e të anketuarve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me **cilësinë e arsimit** në Kosovë; pak më shumë se një e katërta janë të kënaqur ose shumë të kënaqur. Nuk ka dallime domethënëse gjinore në lidhje me këtë pikë.

40% e të rinjve/rejave janë të papunë dhe dallimet gjinore janë evidente. Ndërkohë që në punësimin me kohë të plotë boshllëku gjinor është disi më i vogël, **kur bëhet fjalë për papunësinë e të rinjve, ka dallim domethënës mes të rejave dhe të rinjve**. Lista e punëve dhe sektorëve të preferuar është mjaft e larmishme dhe gjithashtu tregon dallime gjinore. Djemtë/meshkujt e rinj janë më të orientuar drejt bujqësisë, biznesit dhe prodhimitarisë, ndërsa vajzat/femrat e reja priren për punë në administratën publike, shëndetësi dhe arsim.

Normat tradicionale kulturore duket se i dominojnë pikëpamjet e të rinjve për të drejtat dhe rolet e grave në shoqëri. Për shembull, djemtë/meshkujt e rinj janë më të bindur sesa vajzat/femrat e reja se roli më i rëndësishëm i grave është të kujdesen për familjen. Sidoqoftë, duhet theksuar se rreth një e treta e të gjithë pjesëmarrësve në anketë u pajtuan se krijimi i familjes është roli më i rëndësishëm për gratë. Dallimet janë shumë më të larta kur bëhet fjalë për perceptimin e të anketuarve për përshtatshmërinë e burrave për të punuar jashtë shtëpisë kundrejt grave. Në lidhje me shpërndarjen e punëve të ekonomisë familjare dhe

¹References to Kosovo shall be understood to be in the context of UN Security Council Resolution 1244 (1999).

punëve shtëpiake, rezultatet e anketës i konfirmuan vetëm disa stereotipe gjinore. Shumica e pjesëmarrësve në këtë studim besojnë se është e rëndësishme si për gratë/vajzat ashtu edhe për burrat/djemtë të mësojnë se si të kryejnë aktivitete shtëpiake si pastrimi dhe larja. Sidoqoftë, kur merren parasysh punët e tjera të ekonomisë familjare si punimet hidraulike dhe kopshtaria, gjetjet sugjerojnë se shumica e të rinjve pajtohen që burrat/djemtë duhet të jenë më të përgatitur sesa gratë/vajzat dhe duhet të mësojnë si t'i bëjnë këto detyra.

Dallimet gjinore në qëndrime janë të dukshme kur flitet për **normat dhe prirjet shoqërore**: djemtë/meshkujt e rinj i paragjykojnë vajzat/femrat e reja që kryejnë marrëdhënie seksuale para martesës, ndërsa këto të fundit nuk diskriminojnë; djemtë/meshkujt e rinj priren të mendojnë se vajzat nuk janë aq të afta sa djemtë në studimin e shkencave natyrore, inxhinierisë dhe matematikës.

Dallimet gjinore janë gjithashtu të dukshme në **qëndrimet ndaj emocioneve dhe seksualitetit**: djemtë/meshkujt e rinj janë më të gatshëm ta justifikojnë përdorimin e dhunës fizike nëse ofendohen; dhe shumica e pjesëmarrësve në studim konsiderojnë se djemtë/meshkujt e rinj do të preferonin të mos ishin miq me anëtarët e komunitetit LGBTQI+. Është interesante se vetëm një pakicë e të anketuarve meshkuj dhe femra mendojnë se djemtë/meshkujt e rinj nuk kanë nevojë t'i diskutojnë çështje personale me të tjerët.

Korrupsioni dhe varfëria në rritje janë dy **çështje të përgjithshme që i shqetësojnë më shumë të rinjtë**. Vajzat/femrat e reja janë veçanërisht të shqetësuara për **çështjet e sigurisë**. Dallimet gjinore janë gjithashtu të dukshme në çështje si dhuna dhe ngacmimi seksual dhe diskriminimi në bazë të identitetit gjinor ose orientimit seksual. Të rinjtë në Kosovë janë gjithashtu shumë të shqetësuar për nivelin e ndotjes së mjedisit dhe risqet që lidhen me shëndetin. Në të gjitha kontekstet, djemtë/meshkujt e rinj ndihen më të sigurtë dhe më pak të kërcënuar se vajzat/femrat e reja. Teksa shtëpia dhe shkolla/universiteti perceptohen si mjediset më të sigurta, parqet shihen si mjedisi më pak i sigurt. Niveli i kërcënimit nga qentë endacakë konsiderohet i lartë si nga vajzat/femrat e reja ashtu dhe nga djemtë/meshkujt e rinj. Çështje të tjera me kërcënim të konsiderueshëm të perceptuar janë aksidentet e trafikut dhe përdorimi i paligjshëm i armëve të zjarrit. Dallimet gjinore janë të papërfillshme në lidhje me kërcënimin e dhunës së bandave, dhunës etnike, homofobisë, gjuhës së urrejtjes, mizogjinisë, trafikimit të qenieve njerëzore dhe fatkeqësive natyrore.

Dhuna në baza gjinore mbetet një nga shkeljet më të shpeshta të të drejtave të njeriut në Kosovë. Një përqindje shumë e lartë e të rinjve (pothuajse 70% e djemve/meshkujve të rinj dhe 82% e vajzave/femrave të reja) pohojnë se ajo është e zakonshme ose shumë e zakonshme. Veç kësaj, ky studim hulumtoi edhe qëndrimet e të rinjve ndaj skenarëve që reflektohen në mitet që lidhen me dhunën seksuale². Rezultatet e përgjithshme sugjerojnë se shumica e të rinjve në Kosovë nuk i fajësojnë gratë që kanë qenë të mbijetuara të dhunës seksuale në situata që janë të lidhura me sulme seksuale, dhe as nuk kanë qëndrime që i mbështesin ose i tolerojnë përdhunimet³. Sidoqoftë, ka dallime gjinore në përgjigjet ndaj skenarëve që i fajësojnë të mbijetuarat, të eksploruara përmes pyetjeve se çfarë kishin veshur, ku ishin gjatë sulmit, ose nëse ishin të dehura gjatë sulmit. Në të vërtetë, në krahasim me vajzat/femrat e reja pjesëmarrëse, perceptimi i djemve/meshkujve të rinj për episodet e dhunës seksuale ndikohet më shumë nga faktorë të nivelit situacional, duke pasur kështu më shumë gjasa t'u atribuojnë disa përgjegjësi të mbijetuarave. Sidoqoftë, shumica e të rinjve pajtohen se

² Obierufu, P.O., & Ezeugwu, C.R. (2017) "Risqet dhe faktorët mbrojtës psikologjikë në qëndrimet që mbështesin përdhunimin: shqyrtim sistematik", Revista për hulumtime psikologjike dhe edukative, 25 (2).

³ Gravelin, C. R. et al. (2019) "Fajësimi i viktimës së përdhunimit: faktorët individualë, situacionalë dhe socio-kulturorë." Kufijtë në psikologji 9, <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2018.02422>

përdhunimi është gjithmonë i gabuar dhe një akt dhune. Përvojat negative ose të dëmshme janë më të zakonshme tek vajzat/femrat e reja. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se shakatë/komentet e papërshtatshme/të padëshiruara seksuale, pas të cilave vijnë përndjekja dhe ngacmimet online, duke përfshirë abuzimin e bazuar në imazh, janë format më të zakonshme të ngacmimeve seksuale të përjetuara nga vajzat dhe gratë. shumica e të rinjve pajtohen se përdhunimi është gjithmonë i gabuar dhe një akt dhune. **Përvojat negative ose të dëmshme janë më të zakonshme tek vajzat/femrat e reja.** Gjetjet e këtij studimi tregojnë se shakatë/komentet e papërshtatshme/të padëshiruara seksuale, pas të cilave vijnë përndjekja dhe ngacmimet online, duke përfshirë abuzimin e bazuar në imazh, janë format më të zakonshme të **ngacmimeve seksuale** të përjetuara nga vajzat dhe gratë.

Shumica e gjetjeve të anketës janë vërtetuar nga **diskutimet në grupe të fokusit**. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në grupe të fokusit u pajtuan se **çelësi për thyerjen e stereotipeve është edukimi i duhur i fëmijëve**, duke filluar nga vitet e hershme. Për më tepër, një grup i pjesëmarrësve të rinj nga Prishtina e theksuan nevojën për t'i rishikuar tekstet shkollore para ndryshimit të kornizës ekzistuese ligjore.

Të gjitha grupet e fokusit u pajtuan që secili duhet ta gëzojë shoqërinë e kujt të dojë dhe ta ketë lirinë të jetë në **marrëdhënie të të njëjtit seks**, edhe pse disa individë nuk e aprovuan, duke besuar se qëllimi i një marrëdhënieje martesore është riprodhimi.

Pjesëmarrësit në grupe të fokusit theksuan faktin se **prindërit luajnë rol të rëndësishëm në zgjedhjen e profesionit të tyre të ardhshëm**. Prindërit shpesh i shtyjnë vajzat e reja t'i zgjedhin profesionet 'më të lehta' sepse në të ardhmen ato duhet të krijojnë familje dhe ndoshta do të dalin nga tregu i punës ose do ta ndalin karrierën e tyre/do të kalojnë në punë me kohë të pjesshme për t'u kujdesur për familjet/fëmijët e tyre. Krahas kësaj, martesat e hershme dhe normat tradicionale mund të ndikojnë edhe në vendimet për futjen/largimin nga puna apo shkollimi, veçanërisht duke qenë se "në Kosovë është e zakonshme që çiftet të martohen me zakone, para miqve dhe familjes, por presin disa vite që ta regjistrojnë martesën."⁴

Pjesëmarrësit në grupe të fokusit e shprehën **pakënaqësinë e tyre me përpjekjet institucionale për t'u ndihmuar të mbijetuarave të dhunës**. Ata i kritikuan ashpër autoritetet relevante për neglizhencën e tyre në këto raste, duke pretenduar se kjo i shtyn të mbijetuarat të mos i raportojnë incidentet. Faktorë të shumtë **që kontribuojnë në dhunën në baza gjinore** u përmendën nga pjesëmarrësit, duke përfshirë ata psikologjikë (çështjet e menaxhimit të zemërimit), mungesën e arsimimit dhe kushtet e këqija ekonomike.

Në përgjithësi, ka shumë gjetje pozitive në lidhje me pikëpamjet dhe qëndrimet e të rinjve ndaj barazisë gjinore, por studimi tregon edhe ndikimin e qëndrueshëm të normave, praktikave dhe traditave patriarkale. Rekomandimet e këtij studimi përfshijnë mënyra për të siguruar veprim efektiv dhe të qëndrueshëm të fokusuar tek të rinjtë për të avancuar barazinë gjinore dhe për t'i trajtuar normat dhe stereotipet gjinore.

⁴ Analiza gjinore e Kosovës, Rrjeti i Grave të Kosovës, 2018, fq. 25.

2

Konteksti i përgjithshëm

Në Kosovë, si në mbarë Ballkanin Perëndimor, normat dhe sjelljet patriarkale janë mbizotëruese, me një ndarje të fortë gjinore të punëve dhe me pabarazi të konsiderueshme gjinore. Ndërkohë që është bërë shumë përparim në sigurimin e të drejtave ligjore për gratë dhe vajzat, për fat të keq zbatimi i tyre mbetet i dobët. Zbatimi më efektiv i ligjit, arsimimi më i mirë dhe të rinjtë më të fuqizuar janë parakushtet e nevojshme për t'i trajtuar normat patriarkale dhe pabarazinë gjinore. Këto çështje janë veçanërisht të rëndësishme marrë parasysh se Kosova është shoqëria më e re në Evropë me më shumë se 50% të popullsisë së saj nën moshën 25 vjeçare dhe rreth 65% nën moshën 30 vjeçare⁵. Prandaj, ky studim përpiqet që për herë të parë t'u japë politikëbërësve dhe shoqërisë në përgjithësi një analizë të bazuar në fakte të qëndrimeve të të rinjve ndaj gjinisë dhe normave shoqërore.

Barazia, të drejtat e njeriut dhe liria individuale janë pjesë përbërëse e kornizës ligjore ekzistuese në Kosovë, dhe në dy dekadat e fundit është bërë shumë përparim, veçanërisht drejt përafrimit të legjisllacionit me standardet ndërkombëtare të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave.⁶ Legjisllacioni relevant është rishikuar dhe përmirësuar, janë krijuar mekanizma institucionalë dhe janë realizuar hulumtime, programe arsimore dhe plane për avokim. Kjo është e rëndësishme marrë parasysh ndërlidhjen ndërmjet barazisë gjinore, zhvillimit dhe sigurisë njerëzore.⁷ Sidoqoftë, pabarazitë gjinore vazhdojnë të jenë të përhapura në Kosovë, dhe gratë dhe vajzat janë të nën-përfaqësuar, të margjinalizuara, si dhe përballen me sfida shtesë në shumë sektorë.⁸ Shqetësimet kryesore mbeten në lidhje me prevalencën e dhunës në baza gjinore, diskriminimin në tregun e punës dhe boshllëqet në qasjen në drejtësi, financa dhe pronësi.⁹ Veç kësaj, një në tre të rinj në Kosovë nuk është në punësim, arsim apo trajnim, ndërsa shkalla e papunësisë është pak mbi 25%, shqetësim ky edhe më i përhapur tek femrat (32.3% krahasuar me 23.5% të meshkujve).¹⁰

Kosova ka boshllëkun më të madh gjinor në pjesëmarrjen në fuqinë punëtore në Ballkanin Perëndimor¹¹, me 77.5% të femrave jo aktive në tregun e punës krahasuar me 41.1% të

⁵ Struktura moshore e Kosovës. Index Mundi;. Në dispozicion në: https://www.indexmundi.com/kosovo/age_structure.html.

⁶ Progres Raporti i BE-së 2022

⁷ Maxwell Adjei (2019), Pjesëmarrja e grave në procese të paqes: një shqyrtim i literaturës, Revista e edukimit për paqe, 16:2, 133-154

⁸ Akademia Folke Bernadotte dhe UNDP, Kohezioni social në Kosovë: shqyrtimi i kontekstit dhe pikat e hyrjes, 2019.

⁹ Haug H.K. (2015) 'Barazia dhe pabarazia gjinore në Kosovë'. Në: Hassenstab C.M., Ramet S.P. (eds) Barazia dhe (pa)barazia gjinore në Evropën Juglindore. Gjinia dhe politika. Palgrave Macmillan, Londër.

¹⁰ Anketa e Fuqisë Punëtore 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës, https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata___Labour%20market___Anketa%20e%20Fuqisë%20Punëtore___Annual%20labour%20market/tab18.px/table/tableViewLayout1/

¹¹ Grupi i Bankës Botërore. 2017. Promovimi i qasjes së grave në mundësitë ekonomike: Kosova. Banka Botërore, Uashington, DC. Në dispozicion në: <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/29587>

meshkujve.¹² Hulumtimi¹³ ka identifikuar arsyet kyçe për këtë, siç janë mungesa e përgjithshme e mundësive për punë e kombinuar me karakterin gjinor të vendeve të punës në dispozicion, duke i përfshirë pritjet shoqërore që gratë të punojnë në role të papaguara shtëpiake/kujdesi.¹⁴ Këto pabarazi, së bashku me ndikimin e pandemisë në tregun e punës dhe kërkesën në rritje për shkathtësi teknike dhe digjitale, nënkuptojnë se duhet bërë më shumë për ta rritur qasjen e barabartë të grave në zhvillimin e shkathtësive të TIK-ut. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse punëdhënësit kosovarë kanë nënvizuar mospërputhjen ndërmjet shkathtësive dhe kërkesës së tregut, dhe ata gjithashtu vlerësojnë se meshkujt janë shumë më të kualifikuar në demonstrimin e shkathtësive specifike teknike dhe kompjuterike.¹⁵ Efektet e vazhdueshme të papunësisë dhe periudhave të pasivitetit shpesh përfshijnë produktivitet më të ulët dhe akumulimin e kapitalit njerëzor më vonë në jetë, çka nënkupton se femrat mund të shohin se perspektivat e tyre për mobilitet ekonomik në rritje janë dukshëm të kufizuara, gjë që nga ana tjetër ndikon në potencialin e Kosovës për rritje ekonomike.¹⁶ Është vlerësuar se kjo mund të “kapë vlerën e humbjeve të mundshme ekonomike prej rreth 28% në të hyrat bruto për frymë”.¹⁷ Andaj, zgjidhjet e qëndrueshme për boshllëkun gjinor në paga dhe ndarjen gjinore profesionale duhet jo vetëm që ta përmirësojnë përfaqësimin dhe produktivitetin e grave, por gjithashtu t’i adresojnë faktorët strukturorë që nxisin diskriminimin dhe stereotipet gjinore në tregun e punës dhe më gjerë.¹⁸ Gratë dhe burrat nga pakicat dhe grupet e cenueshme¹⁹ duhet të përfshihen në mënyrë të barabartë si pjesë e zgjidhjeve relevante për avancimin e barazisë gjinore dhe zhvillimit.

Raporti i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor për Të ardhmet e përbashkëta (2021) për të rinjtë në rajon vë në dukje se “kur u pyetën për ndikimin e gjinisë në mundësitë e tyre – qofshin ato ekonomike, statusi, fuqia dhe liria e zgjedhjes – të rejtat dhe të rinjtë nuk kishin pikëpamje të forta ose të ndryshme për këtë çështje.”²⁰ Kjo e nënvizon domosdoshmërinë e hulumtimit të vazhdueshëm, diskutimeve të hapura të udhëhequra nga të rinjtë dhe vetëdijesimit më të madh për karakterin gjinor të sfidave kyçe me të cilat përballen të rinjtë në rajon. Kërkohen intervenime të politikave dhe veprime të menjëhershme për t’u ndihmuar të rinjtë që t’i shprehin shqetësimet e tyre dhe të gjejnë zgjidhje për sfidat e shumta socio-ekonomike dhe boshllëqet gjinore që po zgjerohen, të përkeqësuar nga kriza e COVID-19 dhe problemet e vazhdueshme ekonomike.

¹² Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat Sociale, Anketat e Fuqisë Punëtore, TM3, 2021, në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/media/7072/afp-tm3-2021.pdf> (qasur më 21 nëntor 2022).

¹³ Sipas Analizës së Përbashkët të Kosovës (2020), faktorët që kontribuojnë në pjesëmarrjen e ulët të grave në tregun e punës përfshijnë pagat e ulëta, qasjen e kufizuar në kujdesin për fëmijë dhe të moshuar, rregulloret jo mbështetëse të punës (p.sh. kostot e larta të pushimit të lehonisë), normat shoqërore patriarkale dhe diskriminimin.

¹⁴ Instituti Riinvest. 2018. Lehtësimi i fuqizimit Faktorët që ndikojnë në vendimet ekonomike të grave në Kosovë, Në dispozicion në: https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2019/February/20/Womens_economic_empowerment_ENG1550674295.pdf

¹⁵ Alexandru Cojocar (2017) “Diagnostikimi i Punëve në Kosovë” në Seritë e Vendeve të Punës: Nr. 5, Uashington, DC: Grupi i Bankës Botërore, Në dispozicion në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/814361497466817941/pdf/ACS21442-WP-PUBLIC-ADD-SERIES-KosovoJDWEB.pdf>.

¹⁶ Grupi i Bankës Botërore, 2017, fq. 2.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ G20. Nxitja e rimëkëmbjes gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe reziliente të tregjeve të punës dhe shoqërive: Deklaratë ministrore e G20 për punën dhe punësimin, qershor 2021. Në dispozicion në <https://www.g20.org/wp-content/uploads/2021/06/G20-2021-LEM-Declaration.pdf>

¹⁹ Nuk ka një përkufizim të dakorduar të ‘grupeve të cenueshme’, por për qëllimet e këtij studimi, persona të cenueshëm janë ata që preken nga risqet dhe rezultatet e dobëta për shkak të karakteristikave individuale, ndikimit të veprimit ose mosveprimit nga personat e tjerë dhe mjedisit të tyre fizik dhe social. Veç kësaj, cenueshmëria për të rinjtë lidhet gjithashtu me “rritjen, nivele të ulëta të vetë-efikasitetit dhe mirëqenies, parregullsi në sjellje dhe/ose aftësi të reduktuara për punësim, marrëdhënie ndërpersonale, anëtarësim në komunitet dhe qytetari”. Për më shumë, shih Hardgrove. A. et al.. (2014) Cenueshmëritë e të rinjve gjatë tranzicioneve të drejtimit të jetës, UNDP, New York.

²⁰ UNDP, 2021, Të ardhme të përbashkëta: Perceptimet e të rinjve për paqen në Ballkanin Perëndimor, Në dispozicion në: <https://shared-futures.com/wp-content/uploads/2021/06/Shared-Futures-Youth-Perceptions-on-Peace-in-the-Western-Balkans.pdf>

3

Metodologjia e anketës

Ky studim përdori aktivitete si të hulumtimit sasior ashtu edhe të atij cilësor për t'i kuptuar më mirë qëndrimet e të rinjve ndaj stereotipeve gjinore, normave shoqërore dhe sigurisë njerëzore në Kosovë. Hulumtimi sasior konsiston në një anketë të realizuar në 38 komunat e Kosovës, duke përfshirë edhe komunitetet jo shumicë. Ndërsa hulumtimi cilësor përfshin shtatë grupe të fokusit të organizuara me të rinjtë dhe organizatat e shoqërisë civile; kjo shtjellohet më tej në një pjesë të veçantë më poshtë. Duhet të theksohet se këndvështrimi gjinor është përfshirë në të gjitha aktivitetet e hulumtimit.

Anketa sasiore përdori një strategji të marrjes së mostrës që e pasqyron popullatën në nivel komunal, të ndarë në tre grupmosha – 15-19, 20-25 dhe 26-29 vjeçare. Madhësia totale e mostrës është 1,064 të anketuar (tabela 1), e cila konsiderohet e mjaftueshme për të ofruar rezultate statistikiisht përfaqësuese në nivel të Kosovës. Numri i të anketuarve u përcaktua në raport me madhësinë e popullatës komunale (shtresimi i parë) dhe me popullsinë urbane dhe rurale (shtresimi i dytë). Margjina e gabimit për mostrën është +/-3% me nivel besimi 95%. Pyetësi përmbante katër seksione, të cilat ishin të fokusuar në: (i) të dhënat demografike; (ii) zhvillimin e të rinjve; (iii) normat shoqërore; dhe (iv) sigurinë njerëzore.

Për qëllime të këtij studimi u rekrutuan 30 regjistruar për mbledhjen e të dhënave. Të gjithë ata i kaluan dy ditë trajnimi për mbledhjen e të dhënave dhe specifikimin e pyetësorit, me një manual trajnimi specifik për anketën që e shpjegon rëndësinë dhe qëllimet e përgjithshme të anketës. Grupet prej 2 deri në 5 regjistruar punuan nën një udhëheqës ekipi. Menaxheri i anketës i rivizitoi 20% të të anketuarve për çdo regjistruar, me arsyen për t'i falënderuar për bashkëpunimin e tyre, por edhe për t'i ribërë pyetjet më të rëndësishme për verifikim. Secili pyetësor është verifikuar për korrektësi dhe logjikë. Pasi të dhënat u mblodhën duke përdorur Kobotoolbox, rezultatet u analizuan dhe u interpretuan duke përdorur Paketën Statistikore për Shkenca Sociale (SPSS). Kontrollat periodike janë bërë edhe nga menaxheri i anketës, kryesisht përmes krahasimit të mesatareve të ndryshueshme dhe shpërndarjes nëpër të gjithë skedarët, për t'u siguruar që të dhënat nuk janë ndryshuar, qëllimisht ose jo. Gjetjet e hulumtimit në këtë raport bazohen kryesisht në statistika përshkuese duke përdorur teknika të tabelave të kryqëzuara.

Komuna	N	%
Prishtinë	115	10.8%
Prizren	102	9.6%
Ferizaj	62	5.8%
Gjakovë	58	5.5%
Pejë	56	5.3%
Gjilan	55	5.2%
Podujevë	53	5.0%
Vushtri	43	4.0%
Mitrovicë	41	3.9%
Glllogoc	38	3.6%
Suharekë	37	3.5%
Rahovec	36	3.4%
Lipjan	34	3.2%
Malishevë	34	3.2%
Skenderaj	33	3.1%
Viti	28	2.6%
Deçan	26	2.4%
Istog	24	2.3%
Klinë/Klina	23	2.2%
Fushë Kosovë	20	1.9%
Kaçanik	20	1.9%
Kamenicë	19	1.8%
Dragash	16	1.5%
Gračanica	16	1.5%
Shtime	16	1.5%
Mitrovicë e Veriut	15	1.4%
Shtërpcë	15	1.4%
Obiliq	12	1.1%
Hani i Elezit	5	0.5%
Junik	4	0.4%
Zubin Potok	2	0.2%
Leposaviq	2	0.2%
Zveçan	1	0.1%
Novobërdë	1	0.1%
Ranillug	1	0.1%
Partesh	1	0.1%
Gjithsej	1,064	100%

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës

4

Gjetjet e anketës

Pjesa sasiore e studimit kishte për qëllim të testonte dhe vërtetonte të kuptuarit ekzistues rreth qëndrimeve të të rinjve ndaj stereotipeve gjinore, normave shoqërore dhe çështjeve të lidhura me sigurinë. Në strukturën gjinore, përkatësinë etnike dhe shpërndarjen gjeografike, anketa pasqyron të dhënat demografike të disponueshme.²¹ Për shembull, pak më shumë se 50% e të anketuarve e deklaruan veten si vajza/femra të reja krahasuar me 49.2% djem/meshkuj të rinj, dhe një pjesë shumë e vogël (0.4%) që preferonin të mos e deklarorin identitetin e tyre gjinor – një shpërndarje që është pothuajse identike me strukturën e popullatës në Kosovë (tabela 2).

Vendbanimi	Rural	Urban					
	58.5%	41.5%					
Gjinia	Djem / meshkuj të rinj	Vajza / femra të reja	Nuk preferon të përgjigjet				
	49.2%	50.4%	0.4%				
Gjendja familjare	Beqar/e	Bashkëjetesë	I/e shkurorëzuar	I/e martuar	I/e ve	Nuk preferon të përgjigjet	
	75.8%	2.7%	0.7%	19.7%	0.1%	0.9%	
Përkatësia etnike	Shqiptare	Serbe	Ashkali	Boshnjake	Rome	Turke	
	94.5%	4.3%	0.2%	0.3%	0.4%	0.4%	
Neto të hyra mujore të amvisërisë	0-250 EURO	251-400 EURO	401-800 EURO	801-1200 EURO	1201-2000 EURO	>2000 EURO	Nuk preferon të përgjigjet
	1.1%	9.2%	29.0%	28.5%	11.9%	6.7%	13.5%

Tabela 2. Statistikat përmblëdhëse

Në këtë pjesë, rezultatet kryesore të anketës ndahen në tre nënseksione të veçanta: zhvillimi dhe edukimi i të rinjve; stereotipet gjinore dhe normat shoqërore; dhe siguria njerëzore.

²¹ I vetmi burim zyrtar i të dhënave për popullatën është Regjistrimi i vitit 2011; megjithatë, rezultatet janë gjithashtu të validuara me projeksionet vjetore të popullsisë të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).

Zhvillimi i të rinjve

Popullsia e re e Kosovës konsiderohet si një nga asetet më të vlefshme të saj. Sidoqoftë, mundësitë e zhvillimit për të rinjtë mbeten të kufizuara. Përkundër një shkalle relativisht të lartë të arritjeve të përgjithshme arsimore në mesin e të rriturve në Kosovë, kërkesa e kufizuar dhe mospërputhjet e tregut të punës i bëjnë të pasigurta perspektivat për të rinjtë e arsimuar.




Figura 1. Arritjet arsimore

Burimi: Riinvest (2022)

Në përputhje me studimet dhe anketat e mëparshme, anketa tregon (figura 1) se arsimi në nivel universitar është më i lartë në mesin e vajzave/femrave të reja sesa djemve/meshkujve të rinj:^{23 24} Brenda grupmoshës së përgjithshme (d.m.th. 15-29 vjeç) 39 vajza/femra të reja kanë të paktën një diplomë bachelor krahasuar me 28.4% të djemve/meshkujve të rinj. Përqindja e lartë e atyre vetëm me arsim të mesëm mund të shpjegohet pjesërisht me shpërndarjen e moshës së të anketuarve, me 25% të grupmoshës 15 deri 19 vjeç.

²² Anketa për Arsimin për të Rritur në Kosovë (2021), në dispozicion në: https://www.dvv-international.ge/fileadmin/files/caucasus-turkey/Kosovo/Resources/SURVAY___Kosovo_English.pdf

²³ Po aty

²⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021). Arritjet arsimore në arsimin e lartë në Kosovë https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Education__14%20Public%20Universities/4edu.px/




Figura 2. Cilësia e arsimit

Sidoqoftë, arritjet e kënaqshme arsimore nuk duket se përputhen me cilësinë e arsimit siç perceptohet nga përfituesit e tij. Rreth një e treta e të anketuarve janë të pakënaqur (13.3%) ose shumë të pakënaqur (20.5%) me cilësinë e arsimit; pak më shumë se një e katërta janë ose të kënaqur (20%) ose shumë të kënaqur (8%) - figura 2. Këto rezultate përputhen me dëshmitë e mëparshme.²⁵




Figura 3. Pritshmëritë për dobinë e arsimit të arritur

²⁵ Shih FES (2019). Analiza e Sistemit Arsimor në Kosovë <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/15185-20190220.pdf>

Pavarësisht nga niveli arsimor, perspektiva e dobët e punësimit për të rinjtë mbetet një nga çështjet më urgjente socio-ekonomike në Kosovë. Mungesa e vendeve të reja të punës, dhe deri diku natyra strukturore e papunësisë, janë faktorët kryesorë për shkallën e lartë të papunësisë tek të rinjtë në Kosovë. Sipas të dhënave zyrtare të punës të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), shkalla e papunësisë tek personat e moshës 15-24 vjeç ishte afërsisht 30% në vitin 2021. Brenda së njëjtës grupmoshë, shkalla e papunësisë për vajzat/femrat e reja ishte pothuajse dy herë më e lartë sesa për djemtë/meshkujt e rinj.²⁶ Ndër faktorët kyç që kontribuojnë në pjesëmarrjen më të ulët të të rejave dhe grave në fuqinë punëtore janë përgjegjësitë e kujdesit, kufijtë socio-kulturorë, qasja në financa, mungesa e pronësisë, niveli i ulët arsimor, puna e peregjistruar, qasja e dobët dhe rolet gjinore të socializuara.²⁷

Rezultatet e anketës i konfirmojnë të dhënat zyrtare të papunësisë, me 40% të papunë. Në kuadër të kësaj, dallimi gjinor është i mprehtë: 47% e vajzave/femrave të reja janë të papuna krahasuar me 31.5% të djemve/meshkujve të rinj. Dallimet janë gjithashtu domethënëse kur bëhet fjalë për vetëpunësimin: rreth 4% e vajzave/femrave të reja janë të vetëpunësuar krahasuar me rreth 16% të djemve/meshkujve të rinj (figura 4). Këto rezultate janë gjithashtu në përputhje me të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore të ASK-së (AFP) për vitin 2021.




Figura 4. Statusi i punësimit

Preferencat për punë janë të ndryshme. Edhe këtu ka dallime gjinore. Për shembull, djemtë/meshkujt e rinj duket se janë më të interesuar për bujqësi (6.7% e djemve/meshkujve të rinj krahasuar me 0.8% të vajzave/femrave të reja), biznes apo prodhimtari, ndërsa vajzat/femrat e reja shprehën më shumë interes për të punuar në administratën publike, shëndetësi dhe arsim (figura 5).

²⁶ Shkalla tremujore e papunësisë në vitin 2021, në dispozicion në: https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Labour%20market__Anketa%20e%20Fuqis%C3%AB%20Pun%C3%ABtore__Quarterly%20labour%20market/tab21.px/table/tableViewLayout1/

²⁷ 'Analiza gjinore e Kosovës, Rrjeti i Grave të Kosovës, 2018.

²⁸ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata__Labour%20market__Anketa%20e%20Fuqis%C3%AB%20Pun%C3%ABtore__Quarterly%20labour%20market/tab12.px/table/tableViewLayout1/




Figura 5. Preferencat për punë

Mungesa e vendeve të punës dhe papunësia strukturore mund të ndihmojnë edhe për t'i shpjeguar trendet e fundit të emigrimit nga Kosova. Duhet theksuar se struktura e emigrimit ka ndryshuar viteve të fundit. Teksa më parë emigronin kryesisht persona me kualifikime të ulëta, dëshmi të reja tregojnë për largimin e një përzierje të punëtorëve të kualifikuar dhe me shkathtësi të ulëta.²⁹ Të dhënat e anketës tregojnë gjithashtu se prirja për të emigruar mbetet e lartë tek të rinjtë, me 48% të të anketuarve që thonë se po mendojnë të emigrojnë brenda një deri në tre vitet e ardhshme. Shifra është më e lartë mes djemve/meshkujve të rinj – afërsisht 46% krahasuar me rreth 31% të vajzave/femrave të reja (figura 6).

²⁹ Shih GAP (2020), në dispozicion në https://www.institutigap.org/documents/38227_emigration-.pdf




Figura 6. Prirja për emigrim

Prirja e lartë për emigrim tek të rinjtë mund të shpjegohet edhe me faktorë tërheqës dhe shtytës – p.sh. politikat e relaksuara të imigracionit në disa vende perëndimore të BE-së e përforcojnë tregun jopremtues të punës në Kosovë. Faktor mund të jetë edhe aftësia e të rinjve për të marrë vendime në mënyrë të pavarur: 51.3% e djemve/meshkujve të rinj dhe 48.1% e vajzave/femrave të reja thonë se i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur (figura 7). Sidoqoftë, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve ende i konsiderojnë prindërit si ndikuesit kryesorë në vendimmarrjen e tyre. Teksa roli i baballarëve në vendimmarrje konsiderohet disi më i rëndësishëm për djemtë/meshkujt e rinj, roli i të dy prindërve është pak a shumë i barabartë për vajzat/femrat e reja. Veç kësaj, vajzat/femrat e reja priren të kenë më shumë anëtarë të familjes si ndikues në jetën e tyre (p.sh. bashkëshortin, motrën, vëllanë) sesa djemtë/meshkujt e rinj.




Figura 7. Ndikuesit kryesorë në vendimmarrje

Normat shoqërore

Qëndrimet e të rinjve ndaj stereotipeve gjinore dhe normave shoqërore u kapën përmes përgjigjeve të tyre ndaj pohimeve deklarative. Rezultatet u zbërthyen edhe sipas gjinisë. Anketa konfirmon dëshmi anekdotike dhe të grupeve të fokusit se të rinjtë nuk janë të lirë nga stereotipet dhe se ka dallime sistematike mes të anketuarve meshkuj dhe femra në pothuajse të gjitha pikat. Në figurat e mëposhtme, besimet maten me një rezultat intensiteti mes 0 dhe 100, ku 0 nënkupton mospajtim të plotë dhe 100 tregon pajtim të plotë me pohimin e dhënë. Figura 8 sugjeron që si djemtë/meshkujt e rinj ashtu edhe vajzat/femrat e reja besojnë se gratë dhe vajzat duhet të mësojnë t'i bëjnë punët e shtëpisë (pastrimi i shtëpisë, larja, etj.) më shumë sesa burrat dhe djemtë. E kundërta është e vërtetë për punët e perceptuara teknike ose të jashtme (hidraulik, kopshtari), me të dyja gjinitë që pajtohen se burrat dhe djemtë duhet të jenë më të përgatitur për detyra të tilla.

Dallimet gjinore në qëndrime dhe perceptime janë më të dukshme në lidhje me çështje moralisht të papranueshme sipas normave tradicionale, si seksi paramartesor: djemtë/meshkujt e rinj e shohin seksin para martesës më pak të pranueshëm për gratë dhe vajzat, ndërsa femrat e anketuara nuk shohin dallim të madh. Sidoqoftë, duhet theksuar se pavarësisht nga gjinia shumica e djemve/meshkujve të rinj dhe vajzave/femrave të reja janë kundër seksit para martesës. Shumica e të anketuarve (meshkuj dukshëm më shumë se femra) nuk i mbështesin marrëdhëniet mes seksit të njëjtë.

Pohimet	Djem dhe meshkuj të rinj		Vajza dhe femra të reja	
	Vajza dhe femra	Djem dhe meshkuj	Vajza dhe femra	Djem dhe meshkuj
Duhet të mësojnë si bëhen punët shtëpiake si pastrimi i shtëpisë, larja, hekurosja e rrobave dhe përgatitja e ushqimit/gatimi	84.5	65.7	82.9	76.9
Duhet të mësojnë si bëhen punime të vogla hidraulike, elektrike dhe kopshtari	52.4	85.5	56.6	87.1
Duhet të krijojnë familje	86.7	87.2	85.3	85.8
Nuk duhet të bëjnë seks para martesës	50.5	43.5	43.7	41.4
Duhet të jenë në gjendje t'i kontrollojnë ndjenjat dhe emocionet e tyre	76.4	76.8	74.1	74.7
Duhet t'u binden prindërve të tyre	65.3	62.3	62.9	61.7
Duhet të jenë të lirë të vendosin vetë për rrugët dhe zgjedhjet e tyre të karrierës	86.7	88.4	89.1	89.3
Nuk duhet të kenë shoqëri me seksin e kundërt	28.8	26.3	22.6	22.3
Nuk duhet të jenë në marrëdhënie me persona të të njëjtit seks	63.6	64.9	53.0	53.4
Duhet të shkojnë në universitet	89.6	89.3	90.6	91.1

Figura 8. Stereotipet gjinore (0-100)

Dallimet gjinore janë të dukshme edhe në figurën 9, mbi arsimimin dhe pavarësinë e grave. Të pyetur nëse është normale që vajzat/femrat e reja të jenë më pak të arsimuara se të dashurit/burrat e tyre, rezultati mesatar i intensitetit mes djemve/meshkujve të rinj është 17.9 krahasuar me 12.5 tek vajzat/femrat e reja. Në mënyrë të ngjashme, rezultatet tregojnë se djemtë/meshkujt e rinj perceptojnë se vajzat nuk janë aq të afta sa djemtë në studimin e shkencave natyrore dhe disiplinave të tilla si inxhinieria dhe matematika: rezultati është 23.6 për të rinjtë dhe djemtë, krahasuar me 15.6 për femrat e reja dhe vajzat. Dallimet gjinore janë gjithashtu të dukshme në perceptimet për pavarësinë dhe vendosmërinë e grave.

Pohimet	Djem dhe meshkuj të rinj	Vajza dhe femra të reja
Është normale që vajzat/femrat të jenë më pak të arsimuara se të dashurit/burrat e tyre	17.9	12.5
Vajzat nuk janë aq të afta sa djemtë në studimin e shkencave natyrore dhe disiplinave si inxhinieria, shkenca dhe matematika	23.6	15.6
Vajzat/femrat duhet të regjistrohen në disiplina që do t'u lejojnë të gjejnë punë në ekonominë digjitale (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë [STEM] dhe teknologji informacioni dhe komunikimi [TIK]).	53.7	54.8
Femrat duhet të mbështeten financiarisht nga partnerët e tyre	46.9	38.1
Vajzat/femrat janë po aq konkurruese, të sigurta dhe të pavarura sa djemtë/meshkujt	66.9	76.2

Figura 9. Edukimi dhe pavarësia e vajzave/femrave të reja (0-100)

Dallime të ngjashme vërehen edhe në qëndrimet ndaj emocioneve dhe orientimit seksual (figura 10). Djemtë/meshkujt e rinj, në krahasim me vajzat/femrat e reja, janë relativisht më të gatshëm ta justifikojnë përdorimin e dhunës fizike nga ana e meshkujve nëse ata ofendohen. Vajzat/femrat e reja pajtohen më shumë se djemtë/meshkujt e rinj se marrëdhëniet seksuale janë më të rëndësishme për djemtë dhe burrat. Për më tepër, të anketuarit meshkuj besojnë më fort se femrat se shumica e djemve dhe burrave do të preferonin të mos ishin miq me anëtarët e komunitetit LGBTQI+ dhe se djemtë/meshkujt e rinj nuk kanë nevojë të flasin për çështjet e tyre personale me të tjerët.

Pohimet	Djem dhe meshkuj të rinj	Vajza dhe femra të reja
Djemtë/meshkujt nuk qajnë dhe nuk shfaqin emocione në publik	42.6	40.9
Është e pranueshme që djemtë/meshkujt të ushtrojnë dhunë fizike nëse ofendohen	21.8	14.5
Marrëdhëniet seksuale janë më të rëndësishme për djemtë/meshkujt	36.3	41.8
Shumica e djemve/meshkujve nuk do të dëshironin të kishin shoqëri me LGBTQI	62.6	57.3
Djemtë/meshkujt nuk kanë nevojë të flasin për problemet e tyre personale me të tjerët	30.6	21.7

Figura 10. Emocionet dhe sjellja e djemve/meshkujve të rinj (0-100)

Përkundër asaj që mund të konsiderohet progres drejt barazisë gjinore dhe forcimit të të drejtave të grave në Kosovë, në krahasim me burrat, vajzat dhe gratë ende përballen me shumë sfida në jetën e tyre të përditshme. Për shembull, gratë vazhdojnë të përjetojnë diskriminim në lidhje me qasjen në pronë dhe burime sociale, si dhe vazhdojnë të përballen me probleme të sigurisë personale dhe barazisë sociale. Dëshmitë e mëparshme për diskriminimin në baza gjinore në Kosovë mbështeten nga rezultatet e anketës.³⁰ Më saktësisht, ka dallime të dukshme gjinore në perceptimin e të rinjve për sa i përket të drejtave të njeriut dhe mundësive të barabarta. Qëndrimet dhe perceptimet e të rinjve nga anketa vërtetojnë, deri diku, atë që shumë aktivistë të të drejtave të njeriut dhe aktiviste për të drejtat e grave kanë argumentuar – Kosova është ende larg të qenurit një shoqëri me barazi gjinore. Edhe pse dallimet gjinore nuk janë aq të mëdha, rezultati i intensitetit në çështje të ndryshme të të drejtave dhe mundësive është vazhdimisht i ndryshëm mes djemve/burrave dhe vajzave/grave.

Për pohimet më progresive rreth barazisë gjinore, vajzat/femrat e reja priren të kenë nivele më të larta të pajtimit, ndërsa për pohimet më regresive ka pajtim më të lartë mes djemve/meshkujve të rinj (figura 11). Traditat kulturore duket se vazhdojnë të dominojnë në perceptimet e të rinjve për të drejtat dhe rolet e grave në shoqëri. Të anketuarit meshkuj mesatarisht kanë një rezultat më të lartë të intensitetit (47.9) sesa të anketuarat femra (40.2) kur u pyetën nëse roli më i rëndësishëm i grave është të kujdesen për familjen e tyre. Dallimi është më i madh kur bëhet fjalë për përshtatshmërinë e perceptuar të burrave për të punuar jashtë shtëpisë në krahasim me gratë, dhe për idenë se burrat duhet ta kenë fjalën e fundit në vendimmarrjen e familjes. Vlen të theksohet se vlerësimet janë të larta, si tek vajzat/femrat e reja ashtu edhe tek djemtë/meshkujt e rinj, për lidhshmërinë politike të grave, paga të barabarta, mundësi të barabarta në të gjitha sferat e jetës dhe të drejtat pronësore.

³⁰ Rrjeti i Grave të Kosovës (2019), në dispozicion në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2019/05/GBD-Labour-Kosovo_ISBN-978-9951-737-31-9_FINAL.pdf

Pohimet	Djem dhe meshkuj të rinj	Vajza dhe femra të reja
Roli më i rëndësishëm i një gruaje është të kujdeset për familjen e saj	47.9	40.2
Burrat janë më të përshtatshëm se gratë për të punuar jashtë shtetësisë	59.8	43.9
Martesa është më e rëndësishme se karriera	35.0	32.5
Do të ishte mirë të kishte përfaqësim të barabartë të grave si udhëheqëse politike	67.7	79.1
Gratë dhe burrat në përgjithësi duhet të marrin paga të barabarta	75.3	83.0
Gratë duhet të kenë fëmijë që të përmbushen	46.3	41.1
Është përgjegjësi e grave që t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për t'i shmangur shtatzënitë e padëshiruara	34.8	31.8
Nëse ke fëmijë, preferohet më shumë të kesh djem sesa vajza	31.5	17.9
Burri duhet ta ketë fjalën e fundit për vendimet në amvisëri/familje	34.0	19.1
Gruaja duhet ta tolerojë dhunën për ta mbajtur familjen të bashkuar	14.3	10.5
Burrat dhe gratë duhet të kenë mundësi të barabarta në të gjitha sferat e jetës	77.9	83.0
Vajzat/femrat duhet të kenë të njëjtën të drejtë për të trashëguar pronë si djemtë/meshkujt	71.2	81.3
Të rejat në komunitetin tim i kanë të njëjtat shanse dhe mundësi për të punuar si djemtë	55.8	56.3
Burrat janë më pak të aftë për të rritur fëmijë sesa gratë	48.5	47.5
Është gabim që një vajzë/femër të ketë shoqëri me meshkuj	24.5	15.5

Figura 11. Dallimet në rolet dhe pritshmëritë gjinore (0-100)

Siguria njerëzore

Për qëllimet e këtij studimi, siguria njerëzore i referohet mungesës së kërcënimeve dhe padrejtësive, duke përfshirë por pa u kufizuar në sigurinë fizike.³¹ Duke përdorur një shkallë nga 0 (aspak i shqetësuar) deri në 100 (shumë i shqetësuar), të anketuarve iu kërkua që ta shprehnin nivelin e tyre të shqetësimit për aspekte të ndryshme të pasigurisë. Rezultatet e zberthyer sipas gjinisë janë paraqitur si mesatare në figurën 12 më poshtë. Është e dukshme që niveli i shqetësimit në lidhje me të gjitha çështjet e vlerësuara të sigurisë është vazhdimisht më i lartë në mesin e vajzave/femrave të reja (rezultati mesatar i intensitetit 75.9 dhe 67.0 përkatësisht). Të anketuarit janë më të shqetësuar për korrupsionin dhe varfërinë në rritje. Dallime më të dukshme gjinore vërehen në çështje të tilla si dhuna dhe ngacmimi seksual dhe diskriminimi në bazë të identitetit gjinor ose orientimit seksual, ku vajzat/femrat e reja janë më të shqetësuar se djemtë/meshkujt e rinj për këto çështje. Raportimi zyrtar i sulmeve seksuale dhe ngacmimeve ku të mbijetuarat ishin kryesisht vajza/femra të reja, mund të ndihmojë për të shpjeguar dallime të tilla në perceptim. Ndërkohë, të rinjtë në Kosovë janë shumë të shqetësuar edhe për nivelin e ndotjes dhe risqet shëndetësore që ajo paraqet. Ata shprehën gjithashtu shqetësime të konsiderueshme për padrejtësitë sociale në lidhje me të drejtat themelore të njeriut dhe mundësitë e barabarta.

Pohimet	Djem dhe meshkuj të rinj	Vajza dhe femra të reja
Grabitja	57.8	65.1
Të qenurit viktimë e dhunës fizike	54.1	66.0
Sulm terrorist	47.7	54.5
Luftë në rajon	48.1	55.0
Rritja e numrit të emigrantëve dhe refugjatëve	48.2	54.3
Qasja në kujdesin e duhur shëndetësor për sëmundje	54.2	61.7
Ndotja	68.7	74.3
Ndryshimet klimatike	41.1	45.9
Siguria e punës	65.2	69.2
Padrejtësia sociale (të drejtat, mundësitë e barabarta)	67.0	75.9
Rritja e varfërisë në shoqëri	74.0	78.2
Korrupsioni	77.2	79.6
Dhuna seksuale	63.0	74.8
Diskriminimi për shkak të identitetit gjinor ose orientimit seksual	54.0	70.7
Ngacmimi seksual	60.1	75.2

Figura 12. Shqetësimet e sigurisë (0-100)

³¹ UNDP (2016). Doracaku për Sigurinë Njerëzore <https://www.un.org/humansecurity/wp-content/uploads/2017/10/h2.pdf>.

Përgjithësisht (figura 13), djemtë/meshkujt e rinj ndihen më të sigurt se vajzat/femrat e reja në të gjitha mjediset për të cilat u pyetën, sipas një shkalle nga 0 (shumë i pasigurt) në 100 (shumë i sigurt). Teksa shtëpia dhe shkolla/universiteti perceptohen si mjediset relativisht më të sigurta, parqet perceptohen si më pak të sigurta. (Sërisht, pasiguria më e madhe në këtë kontekst në mesin e vajzave/femrave të reja mund ta pasqyrojë historikun publik të ngacmimeve dhe dhunës në baza gjinore në parqe publike.³²)

Pohimet	Djem dhe meshkuj të rinj	Vajza dhe femra të reja
Shtëpia	91.5	90.2
Lagja	82.3	76.0
Fshati/qyteti	80.0	72.3
Shkolla/Universiteti	83.5	79.8
Pub-et/restorantet	73.4	66.7
Parku	64.9	55.6
Zyra	83.2	79.0
Qendra tregtare	72.5	67.1
Vendi i punës	83.7	81.6

Figura 13. Siguria në mjedise të ndryshme (0-100)

Përveç informacionit se sa të sigurt ndihen të rinjtë në mjedise të ndryshme, anketa mbledhi të dhëna edhe për perceptimet për kërcënime specifike, duke përdorur një shkallë nga 0 në 100 ku 0 nënkupton se nuk ka aspak kërcënim dhe 100 kërcënim shumë të lartë (figura 14). Faktorët më kërcënues konsiderohen aksidentet e trafikut, përdorimi i paligjshëm i armëve të zjarrit dhe – në mënyrë të konsiderueshme, marrë parasysh raportimin e sulmeve dhe mungesën e një reagimi të dakorduar institucional – qentë endacakë.³³ Dallimet gjinore janë të papërfillshme, përveç kur bëhet fjalë për kërcënimin e perceptuar nga persona të dehur, ngacmimet seksuale, dhuna seksuale dhe dhuna në familje, ku rezultati mesatar i intensitetit është më i lartë mes vajzave/femrave të reja sesa djemve/meshkujve të rinj.

³² Shih p.sh. një artikull mediatik që mbulon përdhunimin e një vajze 11 vjeçare në një park në Prishtinë në gusht 2022, në: <https://kallxo.com/lajm/dosja-e-prokurorise-11-vjecarja-u-dhunua-ne-park-perderisa-ishte-duke-ecur/>

³³ <https://www.koha.net/metro/343377/qytetaret-edhe-kete-vit-te-rrezikuar-nga-qente-endacake/>

Konteksti	Djem dhe meshkuj të rinj	Vajza dhe femra të reja
Aksidentet në trafik	47.0	49.6
Qentë endacakë	47.5	51.2
Dhuna e bandave	41.5	43.8
Ngacmimi seksual	38.3	47.5
Përdorimi i paligjshëm i armëve të zjarrit	47.3	49.3
Dhuna etnike	36.1	37.5
Trafiku i qenieve njerëzore	42.1	40.3
Ngacmimi dhe abuzimi online	42.9	45.4
Personat e dehur	41.7	46.6
Dhuna në familje	32.5	35.5
Kërcënimet online/kibernetike	41.3	44.1
Dhuna seksuale	38.3	43.3
Abuzimi në familje	32.1	34.6
Homofobia	34.0	35.3
Mizogjinia	31.7	31.1
Gjuha e urrejtjes	37.7	36.6
Trafiku i qenieve njerëzore	31.5	32.8

Figura 14. Perceptimet e pasigurisë dhe abuzimit (0-100)

Dhuna në baza gjinore (DHBGJ) për fat të keq mbetet një nga shkeljet më të zakonshme të të drejtave të njeriut dhe çështjet më të rrezikshme për shëndetin dhe mbrojtjen në Kosovë. Veprat e dëmshme të drejtuara ndaj individëve ose grupeve të individëve për shkak të gjinisë së tyre, i kanë rrënjët në pabarazinë gjinore, abuzimin me pushtetin dhe normat e dëmshme.³⁴ Kjo çështje kërkon një përgjigje të fortë dhe sistematike nga të gjitha institucionet përgjegjëse në Kosovë. Të rinjtë në përgjithësi dhe vajzat/femrat e reja në veçanti janë shumë të shqetësuara për DHBGJ-në. Pothuajse 70% e djemve/meshkujve të rinj dhe 82% e vajzave/femrave të reja thanë se ky fenomen është shumë ose mjaft i zakonshëm (figura 15). Mund të shihet si pozitive që djemtë/meshkujt e rinj janë gjithashtu të vetëdijshëm për gravitetin dhe shpeshësinë e dhunës ndaj grave.

³⁴ UN Women, <https://www.unwomen.org/en/what-we-do/ending-violence-against-women>




Figura 15. Dhuna kundër grave

Anketa hulumtoi edhe qëndrimet e të rinjve ndaj situatave dhe faktorëve që reflektohen në mitet që lidhen me dhunën seksuale. Në një shkallë nga 0-100 (0 = asnjë kontribut, 100 = kontribut shumë i lartë), të anketuarit vlerësuan nivelin e fajësimit të viktimave në skenarë të ndryshëm hipotetikë të përdhunimit (gra me veshje të hapura, të qenurit nën ndikimin e alkoolit, flirtimi me një njohje të re, dhe pjesëmarrja në një ndejë në shtëpi). Rezultatet e përgjithshme sugjerojnë se shumica e të rinjve në Kosovë nuk mendojnë se vetë gratë kanë ndonjë faj për përdhunimin në ndonjë nga skenarët e dhënë. Sidoqoftë, pavarësisht nga shifrat relativisht të ulëta për të gjitha sjelljet, dallimet gjinore janë të dukshme (figura 16), me shumë më shumë meshkuj sesa femra që besojnë se ndikim kanë veshjet e hapura ose dehja.

(Pyetja e saktë – Sa duhet, ndoshta edhe fare, të fajësohet një grua nëse përdhuhet kur ajo:)

	Djem dhe meshkuj të rinj	Vajza dhe femra të reja
Mban veshje të hapura	20.1	10.4
Është e dehur	23.6	16.8
Tregohet miqësore ose flirton me një të njohur të ri	20.7	15.9
Merr pjesë në një ndejë në shtëpi	17.8	12.0

Figura 16. Qëndrimet ndaj fajësimit të viktimave dhe miteve të përdhunimit (0-100)

Të dhënat zbulojnë nuanca të mëtejshme në qëndrimet ndaj dhunës seksuale (figura 17). Shumica e të anketuarve pajtohen se përdhunimi është gjithmonë i gabuar dhe i dhunshëm.³⁵ Shqetësim është edhe mbështetja relativisht e ulët e pohimeve si ‘Nuk është përdhunim nëse është mes partnerëve/bashkëshortëve’ dhe ‘Dhuna në familje është çështje private dhe nuk duhet raportuar’. Vajzat/femrat në përgjithësi kanë këndvështrim më të sofistikuar dhe janë më të vetëdijshme për të drejtat, dhe dallimet më të qarta janë në perceptimet në lidhje me përhapjen e raporteve të rreme të përdhunimeve dhe opsionin që gratë të mos dalin natën për t’i shmangur sulmet, me djemtë/meshkujt e rinj që i besojnë dukshëm më shumë të dyja pikave.

Pohimet	Djem dhe meshkuj të rinj	Vajza dhe femra të reja
Ka shumë raportime të rreme për përdhunim	42.0	27.1
Kur flitet për seksin, meshkujt kanë një pikë nga ku nuk kanë kthim	39.9	49.2
Nuk është përdhunim nëse është mes partnerëve/bashkëshortëve	15.9	13.1
Përdhunimi është gjithmonë i dhunshëm	79.0	82.5
Përdhunimi është gjithmonë i gabuar	83.3	84.1
Përdhunimi shpesh përfshin një partner intim	58.8	56.3
Dhuna në familje është çështje private dhe nuk duhet raportuar	12.1	9.6
Përdhunimi gjithmonë përfshin një të huaj	26.8	23.3
Gratë nuk duhet të dalin vetëm natën nëse duan të jenë të sigurta nga sulmet seksuale	30.3	18.9
Burrat nuk mund të sulmohen seksualisht	28.6	20.4
Burrat nuk mund të jenë viktima të përdhunimit	29.0	20.5

Figura 17. Përdhunimi dhe sulmi seksual (0-100)

Për fund, figura 18 i përmbledh përvojat e të anketuarve me sjellje të dhunshme, abuzive, kufizuese ose të papërshtatshme, në një shkallë nga 0 (kurrë) në 100 (shumë shpesh). Siç sugjerojnë të dhënat, përvojat negative ose të dëmshme janë më të zakonshme tek vajzat/femrat e reja. Abuzimet më të zakonshme të përjetuara nga vajzat/femrat e reja janë shakatë/komentet seksuale të papërshtatshme/të padëshiruara, pas të cilave vijnë përndjekja dhe ngacmimet online, duke përfshirë abuzimin e bazuar në imazh. Dallimet gjinore janë të rëndësishme në të gjitha incidentet e listuara, çka konfirmon se vajzat/femrat e reja në Kosovë kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë në baza gjinore, ngacmim seksual, abuzim apo çështje të ngjashme.

³⁵ Rezultati i intensitetit i matur në një shkallë nga 0-100 këtu pasqyron nivelin e pajtimit me pohimet e listuara (0 “pajtohem plotësisht” dhe 100 “nuk pajtohem aspak”).

Përvojë apo incident	Djem dhe meshkuj të rinj	Vajza dhe femra të reja
Keni qenë në një marrëdhënie ku keni ndjerë se partneri/burri/gruaja juaj ju ka ndaluar të bëni atë që dëshironi	4.3	8.2
Jeni abuzuar verbalisht, poshtëruar ose kritikuar nga një partner, burri ose gruaja	4.8	9.4
Jeni sulmuar apo dhunuar fizikisht nga një partner, burri apo gruaja	2.2	5.5
Jeni prekur në mënyrë të papërshtatshme nga një mësimdhënës/e, koleg/e ose shef/e	2.4	6.8
Keni qenë viktimë e përndjekjes	4.9	12.1
Keni qenë viktimë e homofobisë	1.8	4.8
Kontakt i padëshiruar seksual (p.sh. sulm seksual, përdhunim)	2.2	3.2
Prekje, përqafim ose puthje e padëshiruar nga të huajt	3.5	7.9
Komente sugjестive seksuale ose shaka që ju bënë të ndiheni të ofenduar	5.7	16.0
Dikush që ju dërgon ose ju tregon imazhe, foto ose dhurata të qarta seksuale që ju bënë të ndiheni të ofenduar	4.5	10.9

Figura 18. Përvojat abuzive ose shtypëse

5

Diskutime në grupin e fokusit

Studimi përdori edhe hulumtim cilësor për t'i plotësuar rezultatet e anketës dhe për ta siguruar një paraqitje më të pasur të temave. Shtatë grupe të fokusit u mbajtën me pjesëmarrës të ndryshëm ku mostra është marrë sipas shpërndarjes gjeografike, gjinisë dhe përkatësisë etnike: një me pjesëmarrës të rinj në Prishtinë dhe dy jashtë Prishtinës (duke përfshirë një vetëm me vajza/femra të reja); dy me përfaqësues të OJQ-ve (një në nivel të Kosovës dhe një në nivel lokal); dhe dy me të rinj nga komunitetet jo shumicë (duke përfshirë një vetëm me femra të reja).

Diskutimet në grupe të fokusit u mundësuan pjesëmarrësve t'i qartësojnë, përpunojnë dhe eksplorojnë pikëpamjet e tyre në mënyra që do të kishin qenë më të vështira përmes anketës ose intervistave individuale. Si gjithmonë, diskutime të tilla e mundësuan eksplorimin e hapur të çështjeve me rëndësi për pjesëmarrësit; grupet e fokusit i shtjelluan arsyet pse njerëzit mendojnë dhe ndihen në forma të caktuara, hulumtuan sjellje komplekse, verifikuan ose shpjeguan të dhënat statistikore të nxjerra nga anketat sasiore, dhe ofruan një sasi të madhe informacioni për një periudhë relativisht të shkurtër.

Gjetjet kryesore nga diskutimet në grupin e fokusit mund të përmbledhen si më poshtë:

- Sipas të gjithë pjesëmarrësve, puna në shtëpi është neutrale ndaj gjinisë dhe kur caktohet një detyrë duhet të merren parasysh shkathtësitë, jo gjinia. Të gjithë u pajtuan se kjo temë është ende një problem për shkak të stereotipeve gjinore të shoqërisë dhe pritjeve rreth roleve shtëpiake të vajzave dhe grave.
- Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në të gjitha grupet e fokusit u pajtuan se çelësi për thyerjen e stereotipeve është edukimi i duhur i fëmijëve, duke filluar nga moshë e hershme. Pjesëmarrësit e rinj nga Prishtina theksuan domosdoshmërinë e rishikimit të teksteve shkollore para ndryshimit të kornizës ekzistuese ligjore ose vendosjes së ligjeve dhe rregulloreve të reja. Sipas tyre, 'Abetaret' ekzistuese që në klasën e parë të shkollës ua mësojnë fëmijëve ndarjen e punëve, ngjyrat dhe preferencat e tjera sipas gjinisë.
- Për sa u përket marrëdhënieve të të njëjtit seks, në të gjitha grupet e fokusit pjesëmarrësit u pajtuan që të gjithë duhet ta gëzojnë shoqërinë e kujt të duan dhe ta kenë lirinë që të jenë në një marrëdhënie të të njëjtit seks. Përderisa disa nga pjesëmarrëset u pajtuan se secili ka të drejtë ta jetojë jetën e vet në mënyrën që e shohin të arsyeshme, disa pjesëmarrëse të tjera (vajza/femra të reja jashtë Prishtinës) shprehën mosmiratimin e tyre për marrëdhëniet e të njëjtit seks sepse qëllimi i marrëdhënies martesore është riprodhimi.

- Një çështje tjetër e rëndësishme që u diskutua në detaje ishte arsimimi i vajzave dhe grave, ku anketa kishte treguar se rreth 10% e të anketuarve meshkuj dhe 8% e të gjithë të anketuarve besonin se është normale që gratë/vajzat të jenë më pak të arsimuara sesa burrat. Pjesëmarrësit ia atribuuan këtë rezultat mentalitetit të njerëzve (kryesisht burrave) në zonat rurale, sepse ata besojnë se ky lloj paragjykimi është më i spikatur atje. Më tej, ata shtuan se aktualisht në Kosovë femrat kanë shkallë më të lartë të arritjeve arsimore sesa meshkujt.
- Pjesëmarrësit theksuan se kur bëhet fjalë për zgjedhjen e një profesioni, prindërit luajnë rol të rëndësishëm. Shumë prindër i shtojnë vajzat e reja të zgjedhin profesionet ‘më të lehta’ sepse në të ardhmen ato duhet të krijojnë familje, dhe ndoshta do të dalin nga tregu i punës ose do ta ndalin karrierën e tyre/do të kalojnë në punë me kohë të pjesshme për t’u kujdesur për familjet/fëmijët e tyre. Ky fenomen u konsiderua i padrejtë nga të gjithë pjesëmarrësit, sepse nuk është e pranueshme që vetëm femrat ta sakrifikojnë karrierën e tyre për detyrimet familjare.
- Pjesëmarrësit e shprehën pakënaqësinë e tyre me përpjekjet e shoqërisë për t’u ndihmuar të mbijetuarave të dhunës. Më tej, ata i kritikuan ashpër autoritetet relevante për indiferencën dhe neglizhencën e tyre në këto raste, duke pretenduar se kjo i shtyn të mbijetuarat që mos t’i raportojnë incidentet. Në këtë kontekst u përmend rasti i fundit i një vajze 11 vjeçare të mbijetuar nga sulmi seksual dhe përdhunimi në Prishtinë . Pjesëmarrësit deklaruan se në shumicën e situatave të mbijetuarat kërkojnë ndihmë vetëm nga miqtë e ngushtë ose anëtarët e familjes me të cilët ndihen rehat, ose zgjedhin të mos flasin për shkak të frikës, kërcënimeve ose stigmës sociale.
- Kur u pyetën se çfarë do të bënin nëse do t’u ndodhte diçka e rëndë, shumica e pjesëmarrësve thanë se fillimisht do të flisnin me familjet e tyre. Shumë pak u pajtuan që situata duhet të raportohet fillimisht në polici.

Nga pjesëmarrësit u përmendën shkaqe të shumta të dhunës. Ata i theksuan faktorët psikologjikë dhe theksuan se shumica e njerëzve që janë të dhunshëm e kanë të vështirë ta menaxhojnë zemërimin. Mungesa e edukimit dhe faktorët ekonomikë u përmendën gjithashtu si relevantë. Pjesëmarrësit shtuan se një shkak tjetër i dhunës mund të jetë fakti se shumë burra në Kosovë e kanë të vështirë ta pranojnë barazinë pasi që janë rritur në një shoqëri ku burrat përfaqësojnë lidërshtipin dhe autoritetin në familje. Veç kësaj, asnjëri prej tyre nuk u pajtua që një person duhet të qëndrojë në një marrëdhënie abuzive, madje as për hir të familjes, kryesisht sepse kështu do të rriten vetëm fëmijë të dhunshëm/abuzues.

³⁶ ‘Protestuesit në Kosovë kërkojnë veprim pas përdhunimit të 11 vjeçares’, BIRN, gusht 2022, në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2022/08/30/kosovo-protesters-demand-action-after-rape-of-11-year-old/>

6

Shënime përmbyllëse dhe rekomandime

Ky studim zbuloi disa gjetje pozitive sa u përket standardeve dhe perceptimeve të të rinjve në Kosovë kur bëhet fjalë për barazinë gjinore. Por tregoi edhe se vazhdojnë të mbeten disa qëndrime stereotipike dhe sjellje tradicionale dhe të pabarabarta gjinore. Ky studim mblodhi të dhëna të vlefshme për kushtet sociale, arsimore, të punësimit dhe sigurisë, si dhe nevojat dhe shqetësimet e të rinjve në Kosovë. Ndër të tjera, rezultatet e anketës tregojnë **boshllëqe dhe pabarazi gjinore** në lidhje me arritjet në arsim, kënaqësinë me cilësinë e arsimit, shkallën e papunësisë, emigracionin, aspiratat për karrierë dhe preferencat e punës. Veç kësaj, ka dallime të rëndësishme mes të rinjve dhe të rejave në lidhje me shqetësimet dhe kërcënimet për sigurimin dhe sigurinë personale, duke e përfshirë dhunën dhe ngacmimin në baza gjinore.

Ky studim ka prodhuar gjetje të freskëta dhe të dallueshme rreth qëndrimeve të të rinjve ndaj normave shoqërore dhe gjinore. **Përgjithësisht, rezultatet sugjerojnë se të rinjtë në Kosovë, duke përfshirë djemtë/meshkujt e rinj, janë përkrahës të barazisë gjinore, të drejtave dhe fuqizimit të grave, janë të vetëdijshëm për nevojën për ndryshim dhe të gatshëm që ta luajnë rolin e tyre për një të ardhme më të barabartë.** Duhet të theksohet gjithashtu se shumica e djemve/meshkujve të rinj që morën pjesë në këtë studim shprehën pikëpamje të moderuara për shumicën e temave, çka mund të sugjerojë se gjeneratat e reja janë më pak të ndikuar nga normat e dëmshme patriarkale dhe maskuliniteti toksik. Sidoqoftë, **të rinjtë nuk janë të lirë nga stereotipet gjinore dhe ka dallime mes vajzave/femrave të reja dhe djemve/meshkujve të rinj** kur bëhet fjalë për çështje si rolet shoqërore dhe familjare, atributet dhe shkathtësitë personale, vlerat, përgjegjësitë shtëpiake, seksualiteti, marrëdhëniet, barazia ekonomike dhe mundësitë, dhe faktorët e riskut për DHBGJ, dhuna seksuale, ngacmimi dhe mungesa e përgjithshme e sigurisë personale.

Përkundër disa rezultateve inkurajuese dhe potencialit të të rinjve në Kosovë për të kontribuar në avancimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, nevojiten më shumë hulumtime, burime dhe përpjekje institucionale për ta përshpejtuar ndryshimin dhe adresimin e normave të dëmshme gjinore. Gjetjet e këtij studimi i nxisin **rekomandimet e mëposhtme të fokusuara tek të rinjtë** për institucionet e nivelit lokal dhe qendror, OSHC-të, mediat dhe akterët zhvillimorë të vendosur për t'i trajtuar normat negative gjinore dhe pabarazinë gjinore:

Adresimi i ndikimit të përgjithshëm të normave dhe stereotipeve gjinore tek të rinjtë

- Të realizohen analiza të thelluara të qëndrimeve të të rinjve, në veçanti ndaj roleve, autoritetit, të drejtave dhe sigurisë së vajzave dhe grave në mbarë Kosovën;
- Të realizohet hulumtimi empirik për rëndësinë dhe efektshmërinë e trajtimit të ndikimit të normave gjinore dhe stereotipeve të dëmshme që nga fëmijëria e hershme;
-

- Të mundësohen platforma për dialog dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve, shoqërisë civile dhe sektorit privat, për t'i promovuar përfitimet ekonomike dhe sociale të barazisë gjinore dhe për adresimin e normave dhe stereotipeve gjinore si një mjet thelbësor për çrrënjosjen e diskriminimit në baza gjinore;
- Të hulumtohen sfidat dhe diskriminimi me të cilin përballen të rinjtë që janë pjesë e komunitetit LGBTQI+, të avokohet për të drejtat dhe mbrojtjen e tyre dhe të ofrohet këshillim psikologjik dhe mbështetje ligjore;
- Të promovohen storje pozitive të të rinjve që i thyjnë stereotipet gjinore në komunitete dhe rajone të ndryshme të Kosovës;
- Të ngritet kapaciteti i akterëve kryesorë mediatikë për t'u siguruar që mesazhet e inkurajojnë diversitetin dhe barazinë në shoqëri dhe të mos riprodhojnë ose promovojnë stereotipe gjinore;
- Të mbështeten platformat ekzistuese që e avancojnë barazinë gjinore, si grupet në rrjete sociale, grupet formale dhe informale të të rinjve, rrjetet e shkollave dhe universiteteve, forumet online dhe ueb faqet, dhe forumet rinore në politikë;
- Të mundësohet dialog dhe platforma edukative që u ndihmojnë prindërve dhe të rriturve në përgjithësi të mësojnë për barazinë gjinore dhe rolin e tyre në trajtimin e normave dhe stereotipeve gjinore;

Të organizohen dialogje të udhëhequra nga të rinjtë dhe të përfshihen më shumë të rinj në diskutime që kontribuojnë në barazinë gjinore dhe angazhimin e femrave të reja në vendimmarrje.

Arsim

- Të promovohet integrimi gjinor në hartimin dhe zbatimin e politikave arsimore, duke i përfshirë programet e trajnimit gjinor për mësimdhënësit dhe stafin e shkollave dhe korrigjimin gjinor të materialeve shkollore;
- Të sigurohet që kurrikulat e trajnimit pedagogjik të jenë të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe t'i mbështesin mësimdhënësit për t'i kuptuar stereotipet gjinore dhe paragjykimet e pavetëdijshme në të nxënit dhe zgjedhjet e karrierës;
- Të mbështeten shkollat për të zbatuar politika, hapësira dhe mjedise mësimore të përgjegjshme ndaj gjinisë.
- Të realizohen prova pilot të iniciativave kundër stereotipizimit në arsimin parashkollor dhe në shkolla për të testuar përfitimet dhe efektshmërinë e mjediseve të lojës, të nxënit dhe mësimdhënies, neutrale ndaj gjinisë.
- Të futet edukimi seksual i përshtatshëm për moshën dhe me ndjeshmëri gjinore për të gjithë nxënësit. Edukimi seksual duhet ta mbulojë seksualitetin, zhvillimin njerëzor, orientimin seksual dhe gjininë, autonominë dhe pëlqimin trupor, dhe të jetë i përshtatshëm për moshën.
- Të promovohen praktikat më të mira në edukimin STEM në mjediset shkollore dhe universitare dhe të promovohen vajzat dhe gratë modele në STEM.

- Të promovohen dhe të mbështeten iniciativat për grupet e udhëhequra nga gratë dhe vajzat dhe të fuqizohen aktivistet e reja, veçanërisht nga grupet e pafavorizuara, për të marrë pjesë në konsultime, vendime dhe intervenime për përmirësimin e edukimit për vajzat dhe barazisë gjinore.
- Të avokohet për më shumë gra autore në përpilimin e kurrikulave dhe të literaturës së leximeve plotësuese për nxënësit e të gjitha niveleve.

Tranzicioni në tregun e punës

- Të angazhohen të rinjtë në procesin e identifikimit dhe analizimit të nevojave dhe shqetësimeve të grave në tregun e punës dhe shkaqeve të nën-përfaqësimit të tyre të vazhdueshëm;
- Të realizohen hulumtime të thelluara mbi faktorët kryesorë që e pengojnë qasjen e grave në tregun e punës, veçanërisht të femrave të reja;
- Të hulumtohen dhe të zhvillohen strategji për ta adresuar tendencën, veçanërisht mes të rinjve, për të emigruar për shkak të pasigurisë ekonomike dhe mungesës së mundësive;
- Të sigurohet që politikat e burimeve njerëzore në sektorin publik dhe privat (duke i përfshirë udhëzimet dhe mjetet) të jenë të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe t'i adresojnë stereotipet negative gjinore;
- Të realizohet një fushatë mediatike që e promovon portretizimin pozitiv gjinor të të rinjve në punësim dhe në udhëheqje;
- Të sigurohen strategji arsimore të bazuara në dëshmi dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë, reforma dhe politika që iu përgjigjen trendeve të tregut të punës;
- Të promovohen masa afirmative që i trajtojnë stereotipet gjinore dhe diskriminimin në baza gjinore në arsim dhe në mundësitë për karrierë.

Ekonomia familjare dhe familja

- Të promovohen imazhe pozitive dhe egalitare të grave në shoqëri dhe të theksohet kontributi i grave në themelimin e shoqërive të shëndetshme;
- Të promovohet rëndësia e pjesëmarrjes, rolit dhe kontributit të burrave në familje dhe shoqëri, duke e theksuar vlerën e përfshirjes së burrave në përgjegjësitë shtëpiake dhe të kujdesit, rishpërndarjen e përgjegjësisë shtëpiake dhe të kujdesit dhe rëndësinë e diversitetit të konfigurimeve familjare;
- Të dizajnohen programe dhe infrastrukturë efektive dhe efikase për kujdesin ndaj fëmijëve, kujdesin për të moshuarit dhe paaftësinë, për t'i zhvendosur rolet joproporcionale shtëpiake dhe të kujdesit të grave.

Dhuna dhe ngacmimi në baza gjinore

- Të eksplorohet mënyra se si të adresohen nevojat, të drejtat dhe këndvështrimet e vajzave/ femrave të reja nga Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave (2022-2026) dhe të ndërmerren veprime të përgjegjshme ndaj të rinjve për ta mbështetur zbatimin dhe financimin e parandalimit të bazuar në dëshmi dhe masave mbrojtëse në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave;
- Të realizohen fushata për t'i adresuar keqkuptimet në lidhje me atë që përbën dhunën në baza gjinore, përdhunimin, ngacmimin, sjelljen e pahijshme seksuale dhe abuzimin psikologjik, si dhe për ta rritur vetëdijesimin për masat parandaluese dhe shërbimet në dispozicion të të mbijetuarave;
- Të zhvillohen fushata dhe iniciativa për ta trajtuar maskulinitetin toksik duke i edukuar djemtë/meshkujt e rinj për pëlqimin, respektin, dhunën dhe ngacmimin në baza gjinore, dhe duke ua mundësuar që të jenë aleatë dhe avokatë për barazinë gjinore;
- Të rritet mbështetja për organizatat e drejtuara nga vajza dhe gra që punojnë për t'i dhënë fund dhunës në baza gjinore;
- Të mbështeten bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve, policisë, shkollave, udhëheqësve të komuniteteve dhe familjeve në mbarë Kosovën, për të zhvilluar masa dhe shërbime parandaluese për të mbijetuarat, të përshtatura për komunitete dhe kontekste të ndryshme lokale;
- Të promovohen sinergjitë mes palëve të ndryshme të interesit për ta rritur vetëdijesimin për faktorët dhe sfidat e dhunës në baza gjinore online dhe të lehtësuara nga teknologjia.
- Të sigurohet dizajn i përgjegjshëm gjinor i legjislacionit, programeve, aplikacioneve dhe rrjeteve sociale për ta adresuar DHBGJ online.
- Të vendosen rregullore për t'u siguruar që kompanitë zbatojnë teknologji të saktë të verifikimit të moshës dhe që ueb faqet që përmbajnë pornografi dhe përmbajtje të tjera të dëmshme t'i kenë kontrollet e duhura për ta gjurmuar dhe për ta raportuar aktivitetin e paligjshëm.



QËNDRIMET E TË RINJVE NDAJ NORMAVE GJINORE DHE SHOQËRORE, ZHVILLIMIT DHE SIGURISË NJERËZORE NË KOSOVË

Dhjetor 2022
